

RRUGËTIM NË ROMANET E AGRON TUFËS

Koha e rrëfimit të ngjarjes në romanin “Dueli” të Agron Tufës, e bën veprën të ketë një stil elegant shkrimor. Ajo është e tërthortë dhe e paqartë në esencë. I gjithë dhjetëvjeçari përmbledhet në një roman me numër mesatar faqesh, por më së shumti theksojmë se këto vite janë pjesë e një shtrese tjetër kohore, e kohës psikologjike. “Dueli” shquhet për shtresëzime palimsesike kohore. Njëra shtresë është ngjarja e ndodhur, tjetra është shtrirja rrjedhimore prej dhjetë vitesh, dhe në fund kuptojmë shtresën tjetër kuptimore të romanit: vitet, ngjarja, gjyqi janë pjellë e imagjinatës, e cila buron nga bota e brendshme, koshiente dhe subkoshiente e Martinit.

Si “Dueli” ashtu edhe romani tjetër “Fabula Rosa” janë rrëfyer në kohën artistike, edhe pse duken si kohë reale në pamje të parë. Ligjërimi i rrëfimitarit është shenjë rrëfimore, e cila na ndihmon në përcaktimin dhe interpretimin e analizave të kohës së veprës letrare. Përmes retrospektivës së përdorur, Tufa na sjell një “kohë të manipuluar”, një kohë të përthyer në interesa letrare-stilore. Kemi raste të procedimit kohor në romanin tufian: edhe pse ka kthim mbrapa apo prolepsa, në roman ka raste që romani rrëfëhet në kohën e rrëfimitarit (koha e tashme e rrëfimitarit). Ky rast ndodh më së shumti kur rrëfimtari është i gjithëdijsëm, por i jashtëm, jo dëshmitar i ngjarjes. Ai në këtë rast flet nisur nga koha e tij dhe bashkëkohësia e autorit. Në romanet tufiane ndodh më së shumti koha retrospektive (analepsike dhe prolepsike). Rrëfimtari në romanet e Tufës shfrytëzon kohën gramatikore të së shkuarës, duke u endur në të shkuarën përmes analepsës. Gjithashtu, rrëfimtari paralajmëron, hedh dritëhije se çfarë do të ndodhë në të ardhmen e ngjarjes së treguar. Koha e ngjarjes me kohën e tregimit nuk përputhen në romanet e këtij shkrimtari. Një ngjarje mund të kthehet në të kaluarën ose të paralajmërohet, duke ndryshuar dukshëm shpejtësinë e rrëfimit.

Le të shqyrtojmë analepsën dhe prolepsën te dy romanet e Tufës.

Analepsa vjen si fjalë nga greqishtja e vjetër. Ajo nënkupton kthimin pas në kohë. Kemi dy lloj analepsash: të brendshme dhe të jashtme.

“Mund të përcaktojmë të jashtme analepsën, gjerësia globale e së cilës mbetet e jashtme ndaj asaj të rrëfimit të parë. Ato nuk rrezikojnë kurrë të interferojnë në rrëfimin e parë, funksioni i tyre është vetëm që ta plotësojnë atë, duke i hedhur dritë lexuesit mbi këtë apo atë “precedent”/“veprim të mëparshëm”. Gjërat shkojnë ndryshe për analepsën e brendshme, fusha kohore e të cilave përfshihet në atë të rrëfimit të parë, duke paraqitur në të shumtën e rasteve një rrezik të sigurt për teprim dhe përplasje”.¹

Këto procese na ndihmojnë në përplotësimin e figurës së personazhit, si edhe në një paraqitje sa më të hollësishme e më të detajuar të ngjarjes, por edhe kur “teprohet” në përdorimin e saj, nuk mund të themi se kjo gjë sjell mangësi, për shkak se ajo fiton edhe funksione stilistikore, duke e kthyer kohën në një alegori.

Agron Tufa ka luajtur mjeshtërisht me këtë figurë në romanet e tij. Romani “Fabula Rasa” nis me arsyen e vetëvrasjes së Sheqere Gjeçit dhe ndërpritet duke u futur të tjerë segmente që plotësojnë rrëfimin. Këto pjesë, që janë pjesë të ngjarjes, fillojnë nga faqja 16 dhe deri në faqen 95. Në faqen 96 është një fragment i shkurtër që tregon se Sheqerja është gjallë. Përgjatë këtyre 80 faqeve rrëfimtari shkëput tregimin e ngjarjes për Sheqeren dhe na flet për marrëdhënien e Lilitës me Martinin, mosmbajtja zi e familjes së Martinin për vdekjen e Sheqeres, mosprania në xhenazën e shtëpisë Balla, marrëdhënia e shokut Krenar me familjen e Martinin, bisedat për partinë që zhvilloheshin në tavolinën e ngrënies së shtëpisë së Martinin, biseda e tij me vetveten për vëllain e vdekur. Kapitulli i tretë vijon me bukurinë fizike të Mozës që nuk ishte në proporcion me të babait, trekëndëshi Luljetë - drejtor e Bim Kukaleshi. Kapitulli i katërt sjell kujtimet kur ka qenë i vogël dhe rrinte te gjyshi, dhe vetëm në kapitullin e pestë tregohet se kemi një retrospektivë brenda një retrospektive ku rrëfimtari na përshkruan atmosferën e Sheqeres në shtëpinë e saj, e ku na tregohen gjithashtu detyrimet e saj në jetën bashkëshortore.

1 Gennette G. Figure III. Fv, 90-105 Seuil, Paris, 1972.

Prëftimtari zgjat copëzat e retrospektivave që ka lënë përgjysmë nga faqet e mëparshme duke anashkaluar Sheqeren. Ai e rimerr këtë personazh pas 78 faqesh dhe tregon natën e parë të martesës së saj me Bitak Ballën. Shohim që midis retrospektivave dhe anticipimeve ngjarja e Sheqere Gjeçit shkon rreth shtatë faqe të vendosura jo kronologjikisht, por të shpërndara në të gjithë veprën. Ky segment nuk përbën boshtin kryesor të veprës, por me Sheqeren nis vepra dhe përfundon diku në mes-fund të librit. Boshtin e ngjarjes së rrëfyer tek “Fabula Rasa” e udhëheq Martin Balla. Ai kalon disa peripeci, duke filluar nga nëna e tij që e merr vesh që e tradhton të atin, Elezin, e deri tek zhgënjimi tradhëtor i Lilitës. Ajo ishte e vetmja shpresë dhe motiv i jetës së tij, por edhe Lilita e thyen përfundimisht atë pasi e tradhëton me të panjohurin, qimebakërrin. Ashtu si te “Dueli”, edhe “Fabula Rasa” fokusohet tek ngatërimi i kohëve ku koha e tashme gërshetohet me të shkuarën dhe forma e kohës së shkuar shfaqet sikur të ishte një e tashme e të shkuarës, duke e bërë romanin një vepër tipike moderne.

Tek “Fabula Rasa” kemi të shkuar, të tashme të së shkuarës, të ardhme të së shkuarës, të shkuar. Ky qark rrotullues vijon përgjatë gjithë romanit.

“Mikeshat mbytnë kukurisjen në cepat e shamive të kokës ndër pëllëmbë; vjehrra kruajti fytnin me një kollë të dështuar”.²

“Dëgjo mirë: ne po ikim. Nëse vijnë e na kërkojnë të Habedinit u thuaj se qysh dje kemi ikur në Tiranë te halla, mirë?”³

« A e di sa të urrej mama? Dije, dije: do të të lëshoja një kovë me benzinë- e mandej gjithë kënaqësi - do të të vija shkrepësen dhe do të qaja dhe do të gëzohesha njëherazi». ⁴

*« Ai ua **priste** krahët engjëjve sa herë **vinte** në shtëpi». ⁵*

Të gjitha këto kohë nuk janë të njëpasnjëshme lineare, por janë të ngatërrueshme.

Në kapitullin VII të këtij romani kemi një retrospektivë që plotëson një segment më vete. Bëhet fjalë për babain e Hajredin Ballës, Bitak Balla. Kjo retrospektivë vjen në trajtën e shkak-pasojës. Na jep konturet e përgjithshme të një familjeje tradicionale, patriarkale e plot zakone, ku respektohej i pari i vendit. Bitak Balla ka qenë një burrë i pasur, i zgjuar,

2 Agron Tufa, “Fabula Rasa”, f.9, Ideart,2004.

3 Agron Tufa, “Fabula Rasa”, f.25, Ideart,2004.

4 Agron Tufa, “Fabula Rasa”, f.87, Ideart,2004.

5 Agron Tufa, “Fabula Rasa”, f.68, Ideart,2004.

shpirtgjerë që dinte të falte por edhe të dënonte.

«Rujna Zot, çka qite goje Hamzë a! Qysh munem unë, burr i dheut, ni maxhup me i ra me shpullë atij qi asht Kryet e Dibrës? Po aj të vret, bre Hamzë a»!⁶

« Bitak Balla godet gurin e strallit dhe plas xixën me eshkë. Po ma fort se shkëndia i qesin sytë xixa Bitak Ballës. Maxhin Maxhun ia ka përvesh shpullë fytyrës.

Bitak Balla pa u fiqirue shumë, get manxherren dhe ua njeh. Heshtun e ngadalë. Ia shpe të gjitha fshekët».⁷

Shembujt e mësipërm ndërtojnë një retrospektivë të ardhur nga Edipi dhe na informojnë me prestigjin që gëzonte familja Balla. Ai na kthen në një kohë mjaft të largët për të treguar autoritetin e Bitak Ballës që rridhte në dejet e kësaj familjeje. Ndershmëria, burrëria dhe kryelartësia kanë qenë në këtë familje nga Bitaku, e më pas u trashëgua te Hajredini e më pas te Bitaku (djali i Hajredinit). Maxhupi dënohet për një të shkuar për shkak të shpullës që i jep Bitakut, e ky me anë të vrasjes së maxhupit tregon burrërinë e kryelartësinë e tij, kurse Hajredini dënohet për një të tashme, sepse mendohet që ka abuzuar mbi nusen e djalit. Ky dënim është momental sa zgjat grupi ekspertizës dhe këtu shohim ndershmërinë e tij. Këtë virtut e kishte trashëguar nga i ati. “Sheshpushimi i mbramë” mund të quhet si një lloj epilogu, ku Martini vazhdimisht nxeh të ëmën dhe madje e bën dhe të qajë, kurse i ati nuk flet. Pra, këtu jepet një sqarim përfundimtar në raport me familjen.

Edhe në epilogun e mirëfilltë rrëfimtari trajton një çështje në lidhje me karakterin, qëndresën dhe dobësinë e burrit, e këtë e lidh me Lilitën. Analepsa ka si funksion kryesor pikërisht këtë: të tregojë sa më të plotë figurën e personazhit.

Edhe në romanin tjetër “Duel” analepsa është e përdorur gjerësisht. Siç e përmendëm më lart, ngjarjet tek “Dueli” kanë një shtrirje prej dhjetë vitesh. Kjo lloj anakronie përplotësohet në roman përmes analepsës së brendshme dhe asaj të jashtme. Analepsa e jashtme nuk sjell “problem” për mënyrën sesi funksionon rendi i kronologjisë në rrëfim. Ajo na sjell një paraqitje të plotë të personazhit apo ngjarjes.

Ajo që na intereson më së shumti të theksojmë në lidhje me procedetë e përdorura në këtë roman është analepsa e brendshme. Ky tip i dytë i

6 Agron Tufa, “Fabula Rasa”, f.164, Ideart,2004.

7 Agron Tufa, “Fabula Rasa”, f.163 Ideart,2004.

analepsës nuk është vetëm një përkujtim i një ndodhie, apo një rast që ndodhi në të kaluarën, ajo është pikë kyçe ku zhvillohen ngjarjet në të tashmen e rrëfimit.

“ - Atëherë, ja tek dolëm te pika themelore e ujdisë:

Më lejoni t’ju pyes, zoti Martin e pranoni ju vallë sfidën e duelit me mua?

E pranoj!- tha shkoqur ai, duke mos e druajtur më duhmën”.⁸

Në këtë dialog shihet qartë që bashkëbisedimi i Maksit me Martin Gegën është në të tashmen, por kjo e tashmë është e projektuar në një të shkuar që rrëfimtari na e sjell nëpërmjet analepsës. Sfida ishte e pashmangshme. Maksi nëpërmjet dialogut na informon që Martini ishte i gatshëm jo vetëm të pranonte duelin me të, por të ishte triumfator ndaj këtij dyluftimi.

“Etlevë?

Çfarë?

Aaa

Çfarë është kjo aaa?!

Mm m’u mor goja,- tha ai, -desha të pyesja, e di vallë ti çdo të thotë fjala Alternativë?

Çfarë kërkon të tалlesh, apo si? Sa mirë ia gjete kohën”⁹

Martini ishte shumë i kujdesshëm me familjarët e shtëpisë Kukeli dhe ngacmimet që i hedh Etlevës i bën në momente ku rreth tyre s’ka njeri. Këto provokime ai për një kohë të gjatë i ka pasur në mendjen e tij dhe i ka ndrydhur përbrenda duke mos ia shfaqur asaj. Është pikërisht ky moment kur rrëfimtari na tregon që e brendshmjia e Martinit del jashtë dhe arrin të përfitojë prej saj, një moment që ai e kishte pritur prej shumë kohësh. Shkëndinë e parë e marrim nga ky dialog. Martini i krijon vetë hapësirat për një bisedë jo të drejtpërdrejtë, por tendencioze e ngacmuese. Ai fillon me alternativën (një tregim i shkurtër në lidhje me tregtinë dhe përzgjedhjen e diçkaje) dhe përfundon me Etlevën në pus. Këtu vërejmë një lloj paralelizmi midis alternativës dhe Etlevës. Ai nuk kishte asnjë lloj pikëpyetje për të zgjedhur midis dy alternativave, të përfitonte me Etlevën apo jo, sepse Martini e kishte bërë zgjedhjen e tij. Kjo analepsë e jashtme i vjen në ndihmë boshtit kryesor të romanit që është dueli. Varvara, Lubja dhe Etleva janë pengjet që i rëndojnë atij qoftë nga ana mendore

⁸ Agron Tufa, “Dueli”, f.13,Alpeh,2002.

⁹ Agron Tufa, “Dueli”, f.64,Alpeh,2002.

e qoftë nga ana shpirtërore. Dueli është mjeti që ka përzgjedhur Tufa për ta shpëlarë psikologjinë e M.Gegës. Maksi simbolizon jo vetëm gabimet zanafillore që ndodhen në subkoshiençë, por edhe ato gabime që janë të dukshme, siç është rasti i përfitimit nga këto vajza.

Një nga figurat anakronike më të spikatura në romanet tufiane është edhe prolepsa. Prolepsa vjen nga greqishtja e vjetër dhe do të thotë “para në kohë”. Ajo është një figurë antonimike me analepsën. Sinonimikisht ajo përkufizohet si figura që paralajmëron lexuesin, sjell ngjarjet para në kohë dhe shprehet më së shumti me sistemin kohor të së ardhmes, por jo vetëm. Ligjërimi është mënyra më e mirë për ta shënjuar këtë figurë. Më së shumti kjo figurë është mjaft e dukshme në rrëfime me rrëfimtari dëshmitar të ngjarjes, të vetës së parë. Me anë të subjektivitetit që e karakterizon këtë rrëfim mundet që rrëfimtari ta parashprehë, ta sinjalizojë paraprakisht diçka që do të ndodhë në të ardhmen. Sikurse edhe në trajtimin që i dhamë analepsës, teorikisht edhe prolepsa në varësi të përfshirjes në rendin e ngjarjes mund të jetë e brendshme dhe e jashtme.

“Prolepsat e jashtme funksionin më të shpeshtë të tyre e kanë tek epilogët. Ato shërbejnë për të drejtuar/ludhëhequr linjat e ndryshme të veprimit deri në fundin e tyre logjik, kurse prolepsat e brendshme ngrenë problemin e interferencës, të funksionit të mundshëm të dyfishtë midis rrëfimit të parë dhe atij që merret në segmentin proleptik”.¹⁰

Prolepsat e brendshme lidhin drejtpërdrejt dhe ndikojnë dukshëm në frekuencën e rrëfimit sikurse analepsat e brendshme. Romani “Dueli” është shembulli më i mirë në rastin e një anakronie të tillë. Pa u thelluar ende në analizën e romanit, mund të themi se vetë titulli është një prolepsë.

Autori na paralajmëron përmes titullit që në këtë roman bëhet fjalë për një duel. Pra, ai na parathotë në mënyrë eliptike ekzistencën e një të ashtuquajturit duel (që mund të jetë çfarëdo: fizik, psikologjik apo imagjinar). Nëse do të mbeteshim ende te titulli, vetë fjala “duel” krijon një shtresë proleptike të alegorizuar. Fjala “duel” sipas kuptimit të fjalorit do të thotë:

DUEL,-I m.sh-E-ET Shih DYLUFTIM,-I

DYLUFTIM,-I,-E,-ET. 1.Luftim me armë ndërmjet dy vetave a dy kundërshtarëve sipas disa rregullave të caktuara; luftim me armë ose me shkëmbim zjarri me artileri ndërmjet dy palëve kundërshtare. *Dyluftim me*

10 Gnette G. Figure III. Fv, 105-115, Seuil, Paris, 1972.

shpatë. Dyluftim artilerie. Sport. 2. Përpjekje a luftë e ashpër ndërmjet dy sportistëve ose ndërmjet dy skuadrave që marrin pjesë në një ndeshje a në një garë. 3. Grindje e ashpër dhe e hapët ndërmjet dy vetave; ballafaqim mendimesh a pikëpamjesh ndërmjet dy palëve në sulme a debate të ashpra. Dyluftim diplomatik. 4.fig. Luftë e brendshme midis dy dëshirave, dy ndjenjave ose dy mendimeve të kundërta. Dyluftim në nënndërgjegje.¹¹

Dueli teorikisht dhe tradicionalisht është dyluftim midis dy personave, por njëkohësisht ka edhe kuptimin e dualitetit, të luftimit shpirtëror. Marrim në shqyrtim kuptimin e katërt të fjalorit që na tregon një luftë shpirtërore midis vetes dhe pjesës së brendshme. Të dyja këto trajtime i kemi në vepër. Realisht mendohet të ndodhë një duel midis Martinit dhe Maksit, por alegorikisht ndodh edhe dueli shpirtëror midis Martinit para dhjetë vitesh dhe Martinit në kohën e tashme të rrëfimit, për të përfituar katarsisin shpirtëror dhe njëkohësisht për të përftuar edhe “duelin psikologjik, alegorinë psikologjike”.

Gjithsesi, nisur nga shembujt e mësipërm mund të konkludojmë se t’i ndajmë prolepsat (të brendshme dhe të jashtme) është një guxim, sepse nuk ka një vijë prerëse mes tyre. Prolepsat janë parathënie, paralajmërim dhe kalim në të ardhmen e kohës së rrëfimit.

“Arsyet janë të brendshme, të pakuptueshme prej teje, dhe prej askujt, përveç meje. Mos pretendo të dish atë që ngjet vetëm për vetëm me veten. Sikush gjen aq arsye dhe po aq kundër arsye për të hyrë apo për të mos hyrë në duel. Lum ai, i cili këto arsye dhe kundër arsye nuk i kërkon artificialisht, porse e ndjen të brendshme, të të rrabin zgjuar, në gjumë, në ëndërrime, t’i perceptosh në sy...”¹²

Martini për pak çaste vetëndërgjegjësohet dhe na paralajmëron se dueli nuk është një çështje fizike por ai ndodhet brenda tij. Kjo dëshmohet kur Martini shprehet se arsyet e duelit janë të brendshme dhe atë e shoqërojnë kudo, prandaj është e domosdoshme që ai të dalë në duel. Këtë ia parashtron shokut të tij. Në bashkëbisedimin me Anatolijin ai e lë këtë këtë mendim që sapo shprehu dhe tregon për Maksin si individ. Kjo prolepsë na jep një lajmërim për duelin duke vënë në pikëpyetje nëse është fizik apo jo.

Ndeshim mjaft raste, kur madje brenda analepsës të prolepsohet një situatë. Kjo ndodh më së shumti kur tregohet një ngjarje e së kaluarës dhe

11 Akademia e Shkencave të Shqipërisë, Instituti i Gjuhësisë dhe Letërsisë, Fjalor i gjuhës shqipe, f. 277. Toena, Tiranë, 2002.

12 Agron Tufa, “Dueli”, f.115,Alpeh,2002.

brenda kësaj ngjarjeje paralajmërohet çka ka ndodhur në vazhdim të kësaj ndodhie të treguar në të shkuarën.

Koha leksikore

Fjalë kyçe që vërtetojnë përdorimin e analepsës dhe prolepsës janë:

Analepsa	Prolepsa	Kohë e rrëfimit
Ishte pothuaj fundi i vitit të katërt të shkollës së mesme dhe asokohe Martinit po ia merrte frymën dashuria, dashuri e cila i qe kthyer në lëngatë.	Dueli do të zhvillohet me bërryla, me gjunjë e shqelma, me thonj me dhëmbë, me të gjitha dhuntitë që na ka falur natyr ^a	Kërkoje duelin në një vend dhe në një kohë tjetër.

Edhe pse Tufa në romanet e tij kthehet pas në kohë, analepsat e brendshme mundësojnë që romani të këtë linjë natyrale rrjedhimore, natyrshëm kthehet pas dhe natyrshëm paralajmëron për një ndodhi të caktuar.

Konvencionalisht nisur nga fabula e romaneve të Agron Tufës, kemi disa lloje kohore, të cilat sa shkrihen me njëra-tjetrën, po aq edhe janë qartësisht të kuptueshme. Konkretisht në romanin “Dueli” ngjarja ndodh përpara dhjetë viteve, na rrëfhet brenda njëzet e katër orëve dhe ne e kuptojmë këtë para se ngjarja e romanit të përfundojë.

Koha e fëmijërisë

Ngjarja zhvendoset edhe më tutje, në fëmijëri. Një kujtesë e cila përmbledh simbolikisht jo vetëm vite numerative, por edhe alegorikisht vite mitike. Konkretisht

“Dikur në fëmijëri im atë ishte në burg, dhe nëna dergjej spitaleve e pashpresë, kur të afërmit na kishin braktisur dhe ne, pesë vëllezër dhe motra, vuanim për bukën e gojës, kishim uri dhe çdo gjë e ndanim drejtësisht për pesë. Një dimër nuk e mbaj mend se kush më dhuroi një mollë tepër të madhe me cipën që shndriste nga një e kuqe e thellë. Unë nuk i rezistova tundimit dhe megjithëse

e dija se duhej ta ndaja me vëllezërit e motrat, e kafshova, tulin e verdhmë si krem të këtij fruti dhe goja m'u mbush me lëngun e ëmbël dhe aroma e tij, të cilën e ndiej ende. Pas çdo kafshimi ndjeja keqardhje, aq të thellë, që nëpërdridhej gjer në eshtra. Kur u ktheva në shtëpi më vinte turp të shihja vëllezërit dhe motrën time të zbehur nga uria".¹³

Ky fragment nuk është gjë tjetër veçse një trajtim bashkëkohor i mëkatit fillestar kristian. Molla ka simbolikë fetare-legjendare të mëkatit, të cilën pasi njeriu (Eva sipas kristianizmit dhe Martinit të ditëve tona) e ha, ndien peshën e mëkatit dhe të pendimit.¹⁴

Koha e shkollës së mesme

Në roman tregohet për shkollën e mesme të Martinit, sesi ai i ndërtonte raportet me shokët e klasës dhe mënyra sesi funksiononte jeta shkollore e tij.

Koha e dashurisë (ose e pasionit)

Kjo kohë nis që në shkollën e mesme. Ai kishte simpati ndaj Etlevës prej së cilës iu thye burrëria, sedra dhe zemra kur e lidhën në një trung që të shihte sesi e përdhunonin. Kjo kohë vazhdon më vonë, pasi rriten dhe Etleva është e martuar. Ai arrin të shkojë me të, pasi fiksimi ndaj saj nuk ishte shuar. Madje pasioni ndaj saj ishte aq i madh sa që ai shkeli edhe mikpritjen e njerëzve të asaj shtëpie.

Koha e familjes

Kjo kohë ndodh jashtë analepsës. Kjo është periudha kur Etleva është martuar, ka një familje. Por, kjo kohë, konvencionalisht bashkohet me të kaluarën e saj kur Martini shfaqet dhe vjen në shtëpinë e burrit të saj. Imoraliteti që e karakterizonte, sidomos në shkollën e mesme, i zgjohet kur vjen Martini, duke u rikthyer si në kohën e shkollës së mesme.

¹³ Agron Tufa, "Dueli", f.115,Alpeh,2002.

¹⁴ Agron Tufa, "Dueli", f.116,Alpeh,2002.

Koha psikologjike

Kjo është koha më e rëndësishme e romanit. Gjithçka që ndodh në roman është një paqartësi turbullire, ku nuk ka vijë ndarëse të ngjarjes që ka ndodhur dhe projeksioneve mendore të Martinit. Në fund të romanit kuptojmë që nga titulli “Dueli” e në vazhdim kemi një ngjarje të subjektivizuar në subkoshiençën dhe psikologjinë e Martinit, si një katarsis, “gjqy kafkian”. Konkretisht, koha psikologjike na realizohet përmes Maksit.

Një pjesë nga epilogu i “Duel” thotë :

“Tash e prapa, duhet të pajtohem me fatin tim, e t’i dhimbsem së paku ndokujt tani që po kthehem të flijohem si martir te Porta e Kalasë së Elbasanit nën shiun e pambarueshëm spanjoll...”¹⁵

Epilogu është pjesa më e lëvizshme e romanit dhe sqaron në mënyrë përfundimtare situatat apo ndodhitë që ngrihen në pikëpyetje nga lexuesi. Martinin e shohim si martir, si një individ që është përballur me duelin, dhe si çmim të gjithë kësaj situatë të krijuar, Tufa fut elementin e katarsisit, duke e bërë personazhin e tij të shpëlahet në mënyrë të vazhdueshme nga mëkatet që i rëndonin në shpirt. Shiu i pambarueshëm spanjoll është mjeti që gjen Tufa për katarsisin e Martinit dhe po ky mjet mbyll edhe romanin.

“Ai lexoi atë që qe shkruar në faqe të murit me fillomaster: “Maks mos përdhunoni, - dorëzohemi vetë! Natasha, Ljuda, Zhenja, Bella, Ana, Elena, Masha, Tanja. - Këtu duhet të jetë qeni!”¹⁶

Martini pasi e kishte gjetur vendin e përcaktuar nga Maks i lexon mbishkrime në muret e palestres. Ai edhe e shan duke e quajtur “qen”, pra në njëfarë mënyre ai akoma nuk e ka kuptuar që duelin duhet ta rrëmojë brenda vetes së tij dhe jo të kërkojë hapësira pafund duke u lodhur në kërkim të Maksit.

Kjo lloj situatë e krijuar është paksa paradoksale, sepse më vonë ne e kuptojmë që dueli është i brendshëm, po shenjat që i vijnë Martinit, përballja me Maksin, shkrimet në palestër, frika e Lubjës nga përdhunuesi Maks janë shënjes të kuptimeve psikologjike. Çdo “mëkat” që ai ka bërë në këtë jetë ka dalë nga subkoshienca dhe ka shkruar në koshiençë.

Situatat e papëlqyeshme kanë qenë aq të shumta në numër sa që ai i përjeton ato si të vërteta. Kthimin e tij në botën e njerëzve nuk e realizoi

15 Agron Tufa, “Dueli”, f.145, Alpeh,2002.

16 Agron Tufa, “Dueli”, f.130,Alpeh,2002.

as shoku Anatolij, as vetvetja, por plaku që punonte te palestra sportive. Është zgjedhur plaku si personazh sepse është simbol i mençurisë, filozofisë së jetës, por mbi të gjitha plaku është simbol shkrirje kohore-hapësinore. Ai tërthorazi përmbledh kohën nga lashtësia (tregimi mbi urtësitë e filozofisë së fisit Maja) deri në ditët e fundit kur flet me Martinin.

Përfundime:

Agron Tufa është ndër autorët që ka kontribuar shumë në letërsinë bashkëkohore shqiptare. Ai ka përdorur në veprat e tij teknika të ndryshme dhe të veçanta rrëfimore, sidomos në elementin kohë. Përmes tyre ai veçohet si autori me stil unik, përpjekja e të cilit në këtë lëmë i paralelizon romanet shqiptare krahasimisht me të huajat. Prandaj, guxojmë të themi se Agron Tufa është ndër autorët më me zë dhe që ka sjellë mjaft risi në letërsinë shqiptare. Një konkluzion mjaft i rëndësishëm i këtij punimi është edhe tematika që ka sjellë Tufa dhe mënyra sesi ai e ka trajtuar. Konkretisht, në veprat që kemi marrë në studim, “Dueli” dhe “Fabula Rasa” janë trajtuar tema të thjeshta të realitetit. Përmes kohës, veprimi dhe ngjarjet trajtohen si një ndodhi e zakonshme siç ndodh në përditshmëri. Përshkrimi i jetës në shkollën e mesme, përjetimi i dashurive të para, fatkeqësi si përdhunime, martesë (te “Dueli), vetëvrasje nga një fenomen fiziologjik i nuses (“Fabula Rasa”) janë fenomene jetësore, pjesë e realitetit. Këto ngjarje, artistikisht, përmes analepsës dhe prolepsës fitojnë kolore artistike dhe simbolike, prandaj themi që Tufa është ndër autorët më të rëndësishëm të letërsisë sonë bashkëkohore.

Bibliografia

1. Agron Tufa, “Fabula Rasa” Ideart, 2004.
2. Agron Tufa, “Dueli” Alpeh, 2002.
3. Akademia e Shkencave të Shqipërisë, Instituti i Gjuhësisë dhe Letërsisë, Fjalor i gjuhës shqipe, f.277 Toena, Tiranë, 2002.
4. Zhenet, Zherar: “Figura”, përktheu Sabri Hamiti, Rilindja, Prishtinë 1985.